



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 14, datë 12.07.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin korrik, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:13

Data e mbajtjes së mbledhjes : 12.07.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje ! Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin korrik të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë. I gjithë dokumentacioni ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga sekretaria e këshillit.

Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

Kryetar ke 32 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi **9** pika.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA "TELAT NOGA", PALLATI NR.8, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, 5, 6, RRASHBULL, SUKTH, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2'000'000 (DY MILION) LEKË PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E PANAIRIT "FESTIVALI VEROR I LIBRIT, GUSHT, DURRËS 2022"
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 30'601'000 (TRIDHJETË MILION E GJASHTËQIND E NJË MIJË) LEKË PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR KARBURANT PËR EFEKT TË RRITJES SË ÇMIMIT TË KARBURANTIT
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 51 FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TRETË PARAPRAKE TË 31 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA
7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS MUZEORE DURRËS (QMD), TË PRONËS ME EMËRTIMIN "VENDSTREHIM", ME VENDODHJE NË LAGJEN NR. 1, RRUGA "TAULANTIA", ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 155 M ² , NË INVENTAR TË NDËRMARRJES RRUGA, PRONË E BASHKISË, PËR NJË AFAT 1 VIT, ME TË DREJTË PËRSËRITJE
8.	PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 55, DATË 31.05.2022 "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË

Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	SHPRONËSIMIT PREJ 21561573.6 (NJËZETË E NJË MILION E PESËQIND E GJASHTËDHJETË E NJË MIJË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E TRE PIKË GJASHTË) LEKË, PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA” (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH)”
9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR T’I PROPOZUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË MIRATOJË LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET BASHKISË DURRËS, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “KONSORCIUM PENELOPA” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “PJESË E REPARTIT TË ISH URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 602 M ² , PRONË E BASHKISË DURRËS

Përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 1 të rendit të ditës, me shumicë votash, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, pasi shqyrtoi projektvendimin e përcjellë nga administrata e bashkisë dhe relacionin shoqërues, vendosi unanimisht për miratimin e listës së përfituesve për këtë njësi administrative nr.4 dhe pallati nr.8. Normalisht një saktësim pas disa ankesave, që kemi në rrugë jozyrtare për banorët e këtij pallati duhet theksuar për informacion, që kjo është lista e parë dhe ka raste të tjera që janë në shqyrtim. Thjesht për saktësim, pra nuk është listë përfundimtare.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Atëherë komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Edhe për pikën 2 pasi e mori në shqyrtim Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore propozon me shumicë votash për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini : Gjithashtu dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike arriti në përfundim unanim për kalimin në votim të kësaj pike në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Po, Kryetar.

Dhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Atëherë komente përsa i përket pikës 2, nga ana e këshilltarëve kemi ?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Juliana Osmani.

Juliana Osmani : Po, përshëndetje.

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e vënë në dispozicion lidhur me pikën 3, votoi unanimitisht për këtë pikë dhe propozon për kalimin për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Osmani.

Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit, i jap fjalën znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni ynë lidhur me këtë pikë vendosi me 6 vota pro dhe 1 abstenim për miratimin e përdorimit të këtij fondi prej 2 milion lekësh për mbështetje financiare për organizimin e panairit “Festivali Veror i Librit, Gusht, Durrës 2022”, i cili ka për qëllim sigurisht shumë të mirë, që është promovimi i qytetit të Durrësit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Atëherë përse i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Juliana Osmani.

Juliana Osmani : Edhe për pikën 4, Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave votoi unanimitisht pro dhe propozon për kalimin për votim në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Osmani.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike pasi shqyrtoi gjithë materialet e ardhura nga stafi i bashkisë vendosi unanimitisht për kalimin e kësaj pike për votim në këtë mbledhje.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Atëherë përse i përket pikës 4, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 32 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore, pasi mori në shqyrtim bazuar në relacionin dhe projektvendimin për pikën 5, propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Rroshi.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini : Edhe Komisioni ynë vendosi unanimitisht për miratimin e listës së 51 familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.
Atëherë përsa i përket pikës 5, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve ?
Komente nuk ka, kalojmë në votim.
Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?
Kundra?....
Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 32 vota pro pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim dhe pikën 6 të rendit të ditës propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Rroshi.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini : Gjithashtu dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike vendosi për miratimin e listës së tretë paraprake të 31 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.
Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Dhe Komisioni ynë i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës propozon për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.
Atëherë përsa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?
Komente nuk ka, kalojmë në votim.
Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?
Kundra?....
Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim pikën 7 propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Alfred Mullaraj.

Alfred Mullaraj: Edhe Komisioni ynë është dakort.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Mullaraj.

Përsa i përket pikës 7, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 8**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi : Edhe për pikën 8 Komisioni ynë pasi e mori në shqyrtim, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Mullaraj.

Alfred Mullaraj: Edhe Komisioni jonë është dakort për kalimin e kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Mullaraj.

Përsa i përket pikës 8, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 9**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore edhe për pikën 9, propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Rroshi.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Alfred Mullaraj.

Alfred Mullaraj: Edhe Komisioni jonë është dakort të kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë përsa i përket pikës 9, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

Ani Dyrmishi: Duke qënë se kjo është një mbledhje jashtë radhe dhe askush se ka kërkuar fjalën për të diskutuar, Ju falenderoj të gjithëve për pjesmarrjen.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 8 (tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI